

## **P a r a t h ë n i e**

Riaktivizimi i Sistemit të Statistikave Demografike, pas lufte me 1999, fillimisht është bërë e me ndihmën e CIDA-s (Canadian International Development Agency), për fazën e parë, dhe me Qeverinë Holandeze për fazën e dytë-UNFPA ka qenë si agjencion ekzekutiv i projektit.

ESK përfiton nga rasti ti falenderoj me respekt të veçant donatorët e përmendur dhe donatorët tjere për mbështetjen e tyre të vazhdueshme për rindërtimin e Sistemit të Statistikave Demografike në Kosovë.

Ky është buletini i parë me të dhëna përfundimtare, për vitet 2002 dhe 2003, pas riaktivizimit të Sistemit të Statistikave Demografike, në korrik të vitit 2001.

Burimi i të dhënave për statistikat e jetës, janë Librat Amzë, ndërsa njësi raportuese, Zyrat e Gjendjes Civile (Ofiqaritë).

Grumbullimi i të dhënave është bërë përmes instrumenteve të veçanta statistikore : Formulari ststistikor për lindje (DEM-1), Formulari ststistikor për vdekje (DEM-2) dhe Formulari ststistikor për kurorëzime (DEM-3).

Sipas dispozitave ligjore mbi udhëheqjen e librave amzë, rastet e lindjeve, vdekjeve dhe kurorëzimeve regjistrohen në mënyrë obligative në librat amzë në vendin në të cilin kanë ndodhur ngjarjet, pa marr parasysh se personat me të cilët lidhet ngjarja, jetojnë në atë vend apo në ndonjë vend tjetër.

Rezultatet e statistikave demografike përpunohen sipas principit të vendbanimit të përhershëm të personit, që sipas rregullave ndërkombëtare i përgjigjet konceptcionit të popullatës së përhershme (rezidente), e cila aplikohet edhe me rastin e regjistrimit të popullsisë.

Në këtë buletin jipen shkurtimisht informatat në lidhje me fenomenet vitale që kanë ngjarë gjatë vitit 2002 dhe 2003, dhe shpjegon prapavinë dhe rëndësinë e informatës për statistikat e jetës. Gjithashtu janë dhënë disa shpjegime metodologjike, analiza të shkurtëra, dhe në fund janë të prezentuara tabelat me të dhëna në shkallë vendi dhe sipas komunave.

Me rastin e shfrytëzimit të këtyre informatave të publikuara në këtë buletin, DSD i ESK me respekt do ti pranoj sygjerimet, propozimet dhe vërejtjet eventuale të cilat do të na ndihmojnë që në të ardhmen ta begatojmë përmbajtjetn e tij.

Prishtinë, Nëntor 2004

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,  
Hysni Thaçi

## **Kapitulli I: Sistemi i Statistikave Demografike në Kosovë**

### **1.1 Historiku i shkurtër**

Të dhënat për lindje, vdekje dhe kurorëzime gjatë viteve 1900-1912 janë siguruar përmes teftereve turke, të cilat i kanë udhëhequr në zyra të veçanta administrative dhe në institucionet fetare.

Edhe në periudhën e viteve 1921-1939, të dhënat për statistikat e jetës janë siguruar kryesisht përmes evidencave në institucionet fetare (kishave dhe xhamive), një pjesë e vogël është siguruar përmes ofiqarive shtetërore, ndërsa shkurorëzimet përmes gjykatave kompetente për shkurorëzime.

Pas luftës së dytë botërore, funksionimi i Sistemit të Statistikave Demografike në Kosovë fillon në vitin 1947, dhe të gjitha të dhënat për statistikat e demografike (lindjet, vdekjet dhe kurorëzimet) janë siguruar përmes zyrave të ofiqarive, ndërsa për shkurorëzime nga gjykatat kompetente për shkurorëzime.

Rrënimi i SSD nisë me fillimin e çregullimeve politike në Kosovë në vitin 1989, ndërsa shkatërrimi total gjatë luftës më 1999, gjë që pason me çregullimin dhe rrënimin e shumë zyrave të ofiqarive si dhe asgjësimin dhe vjedhjen-tërhjekjen e shumë librave amzë (në disa komuna edhe librat amzë prej vitit 1900) në Serbi.

Përpjekjet e para për fillimin e funksionimit të këtij institucioni bëhen në fund të vitit 1999, kur UNMIK-u formon regjistrin e ri civil të cilin e jetësoi, duke botuar certifikata të reja dhe libra amzë.

Pas rifillimit të procesit të regjistrimit civil, sigurimi i të dhënave për statistikat demografike është emërtuar si prioritet i respektuar, është titulluar “Riaktivizimi i Sistemit të Statistikave Demografike”, dhe është planifikuar me Departamentin e Statistikave të Popullsisë të ESK.

Ndihma e përgjithshme teknike është siguruar nga Univerziteti i Montrealit në Kanadë, dhe më pastaj edhe nga qeveria holandeze.

Në gusht të vitit 2001, fillon riaktivizimi i SSD, me grumbullimin e të dhënave për lindje, kurorëzime dhe vdekje.

Në janar të vitit 2004, DSP riaktivizon edhe pjesën tjetër të SSD- shkurorëzimet, rezultatet e të cilit priten në vitin 2005.

## **1.2 Burimet e të dhënave, mbledhja dhe procesimi**

Burimi i vetëm dhe kryesor i informatave për statistikat demografike, është evidenca në Librat Amzë për lindje, vdekje dhe kurorëzime, të cilat mbahen në Zyrat e Gjendjes Civile (Zyrat e Ofiqarive).

Për lindjet dhe vdekjet që ndodhin në spital, personeli mjekësor, i plotëson formularët statistikor, për lindje DEM-1 dhe për vdekje DEM-2.

Një kopje të formularit të plotësuar, institucioni mjekësor e ndalë për nevoja administrative, një kopje i dorëzohet personit për të cilin është e lidhur ngjarja, ndërsa dy kopje të formularit (njera e dedikuar për ESK) dërgohen në Zyren e Gjendjes Civile.

Zyrat e gjendjes civile pasi i regjistrojnë ngjarjet në librat amzë, një kopje të formularit statistikor e dërgojnë në ESK.

Sipas rregullativës ligjore, por edhe me rekomandime metodologjike është precizuar, që ngjarjet vitale duhen të regjistrohen aty ku edhe ndodhin .

Gjatë përpunimit, dhe me rastin e publikimit, të dhënat grupohen sipas vendbanimit të përhershëm: për rastet e lindjeve sipas vendbanimit të përhershëm të nënës së fëmiut të lindur, për rastet e vdekjeve sipas vendbanimit të përhershëm të personit të vdekur dhe për kurorëzime sipas vendbanimit të përhershëm të kurorëzuarve.

Sa i përket kalkulimit të nivelit të ngjarjeve dhe informatës për statistikat demografike, të dhënat publikohen sipas veçorive kryesore si: mosha, gjinia, përkatësia kombëtare, komunat/ vendbanimet, përgatitja shkollore, fertiliteti, etj. që zakonisht kërkohen edhe me regjistrimin e popullsisë.

Është shumë me rëndsi të kuptohet dhe të zbatohet rregullativa ligjore e cila i obligon qytetarët e Kosovës që të regjistrojnë me kohë ngjarjet vitale, në librat amzë, në zyrat e gjendjes civile.

### 1.3 Rëndësia

Për ta analizuar situatën demografike të një vendi, burimet kryesore sigurohen nga të dhënat e fituara nga Regjistrimi i Popullsisë ( i cili sipas rregullave të Kombeve të Bashkuara realizohet në çdo dhjetë vjet), dhe Sistemit të Statistikave Vitale. Këtyre informatave iu pason edhe pjesa tjetër e të dhënave të popullatës dhe variablat kryesor demografike siç janë nataliteti, mortaliteti, dhe migracionet. Këta janë tre faktor përmes së cilëve maten ndryshimet në popullsinë e një vendi.

Nga kjo rjedhë se: popullsia e një vendit rritet apo zvogëlohet me shtimin natyral pozitiv apo negativ dhe në bazë të saldove pozitive apo negative të migracioneve ( d.m.th. popullsia e një vendit rritet kur një fëmijë lindë ose kur ndokush nga jashtë vjen të jetojë në atë vend, kurse popullsia e një vendit zvogëlohet kur dikush vdes ose ndokush largohet për të jetuar në ndonjë vend tjetër).

Kjo mund të prezentohet edhe me këtë formulë:

$$P_1 = P_0 + (L - V) + (I - E)$$

- P<sub>1</sub>** - është vlerësimi i popullsisë për fund të vitit,
- P<sub>0</sub>** - numri mesatar i popullsisë në mes të vitit,
- L** - numri i lindjeve të gjalla brenda vitit kalendarik,
- V** - numri i vdekjeve brenda vitit kalendarik,
- I** - numri i imigrimeve, dhe
- E** - numri i emigrimeve brenda vitit kalendarik.

Në bazë të këtyre parametrave, numri i popullsisë së një vendi mund të llogaritet, vlerësohet dhe prognozohet saktësisht, nëse numri i lindjeve, numri i vdekjeve dhe saldo e migrimit, janë të sakta.

Sidoqoftë, sistemi i tanishëm i regjistrimit të ngjarjeve demografike, mbledh informata vetëm për lindjet, vdekjet dhe kurorëzimet, ndërsa mbledhja e shënimeve për migrime ende është në diskutim e sipër.

Që të mund të arrihet zënja e ngjarjeve, në shkallën e nivelit dhe cilësisë së duhur, DSD ka organizuar trajnime, seminare/takime dhe diskutime në nivel qendrorë, rajonal, dhe komunal.

DSD, është i vetëdijshëm, se kjo nuk mund të arrihet pa ndihmën dhe përkrahjen e të gjithë shfrytëzuesve dhe pjesëmarrësve kryesorë që janë në procesin e mbledhjes së shënimeve, e sidomos të institucioneve të cilat ndërtojnë infrastrukturen ligjore dhe obligojnë zbatimin e saj.

Gjithashtu është e nevojshme që të sigurohet hapësira për pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile, për ngritjen e kulturës, paraqitjen e ngjarjeve demografike, si komponentë shumë e rëndësishme e një shoqërie bashkëkohore.

Tani, Sistemi i Statistikave Demografike në Kosovë është duke funksionuar që nga gushti i vitit 2001, dhe në bazë të rezultateve preliminare, por edhe këtyre përfundimtare, krahasuar me periudhat e më hershme 1948-1990, është konstatuar se edhe përkundër angazhimit të DSP, nuk ishte e mundur zenja e lindjeve më shumë se reth 85% dhe vdekjeve më shumë se reth 65%, që nënkupton se nuk janë përmbushë kriteret e KB për mbulimin e ngjarjeve, që të jenë të krahasueshme me ato ndërkombëtare.

Kjo gjendje na sinjalizon se duhet të ndërmerret diçka në përmirësimin, gjegjësisht në ndryshimin dhe plotësimin e infrastrukturës ligjore e cila rregullon sistemin e shërbimit të gjendjes civile në Kosovë, sidomos pjesa e cila ka të bëjë me regjistrimin e lindjeve dhe vdekjeve.

### **1.5 Aktivitetet e përfunduara**

Deri në riaktivizimin e Sistemit të Statistikave Demografike, në muajin korrik të vitit 2001, janë përfunduar shumë aktivitete, në faza të caktuara.

Aktivitetet kryesore të zhvilluara për

fillimin e rindertimit të SSV në Kosovë

- Nëntor 1999 UNMIK-u e vë në sistem regjistrin e ri civil komunal
- Janar 2000- Zyret e Regjistrit Civil në komuna filloj ti lëshoj çertifikatat për lindje, vdekje dhe kurorëzime.
- Mars 2000-UNMIK-ofron rregulloren numër 2000/13 për Qendrën e Regjistrit Civil.
- Tetor 2000- është nënshkruar kontrata në mes të UNFPA-së dhe ESK-së për riaktivizimin e Sistemit të statistikave demografike.
- Analiza gjegjësisht inqizimi në teren i gjendjes së sistemit të regjistrit civil (raporti i përgatitur nga DSDi është dërguar drejtorit të UNFPA-s z. Olivie Brazerit )
- Shkurt 2001: Zt. Gani Kadriu dhe Zt. Kadri Sojeva, në Univerzitetin e Montrealit, në Kanada, konsultojnë përvojat e SSD.
- Janar-shkurt: Zt.Simon Yana, vizitohet Kosovën. Z Yana i Universiteti të Montrealit është punësuar nga UNFPA-ja si këshilltar i projektit të SSD në DSD të ESK.
- Në fillim të vitit 2001: Gani Kadriu, Kadri Sojeva, Simon Yana dhe Tite Habiyakare vizituan Shqipërinë dhe Maqedoninë.
- U bënë edhe vizitat në fushën e SSV në territorin e Kosovës nga një ekip i formuar nga Gani Kadriu dhe Simon Yana.
- Janar-shkurt 20001: Zt.Viktor Piche dhe Jean Lachapelle nga Univerziteti i Montrealit vizituan ESK-në.
- Mars-korrik 2001- janë shqyrtuar bazat legale dhe draftrregulloret janë dërguar në Zyrën e regjistrit civil, janë përgatitur formularët dhe librat e instruksioneve për grumbullimin e ngjarjeve vitale ( lindjeve, vdekjeve, dhe martesave).
- Qershor 2001- Trajnimi i stafit të ESK-së, stafit të regjistrit civil, dhe stafit mjekësorë, janë diskutuar formularët dhe janë përfunduar
- Qershor-gusht 2001 është organizuar takimi mbi përhapjen e propagandës (vetëm posterët janë publikuar)
- Gusht, 2001- Filloj funksionimi i Sistemit të SD i rindërtuar pas luftës më 1999.
- Dhjetor 2001- është nënshkruar memorandum i mirëkuptimit në mes të Qendrës së Regjistrit civil dhe ESK-së, mbi mbledhjen e shënimeve nga Sistemi i Regjistrit Civil, për ngjarjet demografike.
- Janar,2002- është instaluar Sistemi i Regjistrit Demografik.

- Janar-shkurt, 2002- Vlerësimi i projektit të fazës së parë nga Louise Lapointe, CERAC inc Univerziteti i Montrealit
- Mars 2002- Simon Yana dorëzoi rezultatet përfundimtare të aktiviteteve të fazës së parë të SSV.
- Maj 2002 – U punësuan dhe u trajnuan gjashtë punëtorë për hedhjen e të dhënave në sistemin e TI, të cilët u sistematizuan në vende tjera të punës, pa e përfunduar përfshirjen e të dhënave të statistikave vitale.
- Qershor, 2002- hedhja e të dhënave filloj për pesë muajt e fundit të vitit 2001, dhe vazhdoi për vitet 2002 dhe 2003.
- Nga qershori 2002 deri në mars 2004, në mungesë të ekspertëve në Qendrën e TI së ESK, për përpunimin e të dhënave, tabelat e konstruara nga DSP për publikimin e të dhënave përfundimtare dhe shpërndarjen e informatave për ngjarjet vitale në Kosovë, mbeten të paplotësuara
- Qershor, 2002- UNFPA- cakton Zt. Prabhat Dixit nga Nepali, këshilltar teknik/ ekspert i Demografisë për ndihëm DSD.
- Shkurt 2004: Ardhja e Zt. Hysni Thaqi, Kryeshef Ekzekutiv i ESK, në prill 2004, siguron ekspertin për përpunimin e të dhënave në Qendrën e TI, dhe kështu zhbllokoi pengesën e vetme dhe kryesore e cila plot dy vite e pengoi realizimin e fazës së tretë të SSD për prodhimin e informatave për ngjarjet vitale në Kosovë.

## **1.6 Aktivitetet që priten të realizohen**

-Për të rumbullakësuar sistemin e statistikave vitale, DSD do të angazhohet:

- për sigurimin e burimit të t' dhënave edhe për *migracione*, si komponente domosdoshme për llogaritjen (vlerësimin) e sakt të numrit të popullsisë.
- Do të inicioj aktivitetet tjera të nevojshme teknike, organizative, profesionale dhe sistimore për *ngritjen e shkallës së zënjes së ngjarjeve vitale* (lindjeve dhe vdekjeve) në kohë, si dhe ngritjen e shkallës së cilësisë së informatave të prodhuara dhe shpërndarjen e tyre shfrytëzuesve.
- Ne veçanti duhet të bëhen përpjekje, me qëllim që të ngritet numri i formulareve të regjistruar për statistikat demografike, që vijnë nga vendbanimet me popullatë serbe.

## 1.7 Vlerësimi i numrit të popullsisë

### Lëvizjet e popullsisë

Duke i analizuar të dhënat për lëvizjet natyrore të popullsisë, në periudhën 1948-1997 (gjendja në mes të vitit), kuptojmë se mesatarja e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë, sillej rreth 33673 veta, me normë mesatare vjetore 24.7 promil, gjegjësisht me një shkallë vjetore të rritjes 2.2%.

Në periudhën 1991 deri 1997, mesatarja e shtimit natyror të popullsisë ishte rreth 37187 banorë ose me normë mesatare rreth 18.0 promil. Shkalla vjetore e rritjes së popullsisë së Kosovës për periudhën e cekur ka qenë 1.775%.

#### Lëvizjet e popullsisë - vlerësim

Viti	Numri i banorëve (000)
1991	1 967
1992	2 006
1993	2 043
1994	2 077
1995	2 113
1996	2 151
1997	2 186

Burimi: Vjetari statistikor i Serbisë 1998 faqe 42. Tab.3-2

### Vlerësim

Në mungesë të të dhënave për numrin e popullsisë në Kosovë, që nga regjistrimi i fundit i viti 1981, me qëllim të krijimit të elementeve bazë për llogaritjen e disa treguesve analitik për statistikat demografike, na imponohet nevoja që të i përdorim edhe të dhënat nga vjetari statistikor i Serbisë, në mënyrë që në bazë të metodave statistikore për vlerësime, prognoza dhe projeksione, të bëjmë vlerësimn për numrin e popullsisë në Kosovë për periudhën 1998-2004. Të dhënat për numrin e përgjithshëm të popullsisë për periudhën në fjalë, janë vlersuar dhe janë kalkuluar me shkallën vjetore të rritjes prej 1.775%.

#### Lëvizjet e popullsisë

Viti	Numri i banorëve (000)
1998	2 225
1999	2 264
2000	2 304
2001	2 345
2002	2 387
2003	2 429
2004	2 473

Vlersim: Divizioni i Statistikave Demografike i ESK

## 1.7 LËVIZJET E POPULLSISË 1948-1997

Vitet	Popullsia me 30.06 në(000)	Lindjet	Vdekjet	Foshnjete vdekura	Shtimi natyror	Në 1000 banorë			Foshnjete vdekura në 1000 lindje të gjalla
		Gjithsej	Gjithsej			Lindjet	Vdekjet	Shtimi natyror	
1948	733	27 792	10 324	...	17 468	37.9	14.1	23.8	...
1949	751	31 643	12 927	4 208	18 716	42.1	17.2	24.9	133.0
1950	764	35 222	12 991	4 977	22 231	46.1	17.0	29.1	141.3
1951	780	29 299	14 833	5 103	14 466	37.6	19.0	18.5	174.2
1952	793	35 619	13 867	5 197	21 752	44.9	17.5	27.4	145.9
1953	813	34 595	16 726	5 999	17 869	42.6	20.6	22.0	173.4
1954	832	38 595	13 201	5 520	25 394	46.4	15.9	30.5	143.0
1955	842	36 736	15 292	6 025	21 444	43.6	18.2	25.5	164.0
1956	859	37 819	13 692	5 175	24 127	44.0	15.9	28.1	136.8
1957	873	34 159	15 300	5 464	18 859	39.1	17.5	21.6	160.0
1958	890	39 285	11 598	4 928	27 687	44.1	13.0	31.1	125.4
1959	921	37 364	12 878	5 190	24 486	40.6	14.0	26.6	138.9
1960	944	41 631	13 365	5 518	28 266	44.1	14.2	29.9	132.5
1961	972	40 561	11 759	5 108	28 802	41.7	12.1	29.6	125.9
1962	997	41 336	15 024	6 072	26 312	41.5	15.1	26.4	146.9
1963	1 021	41 525	12 423	5 351	29 102	40.7	12.2	28.5	128.9
1964	1 046	42 557	12 731	5 418	29 826	40.7	12.2	28.5	127.3
1965	1 075	43 569	11 767	5 341	31 802	40.5	10.9	29.6	122.6
1966	1 101	42 429	10 266	4 357	32 163	38.5	9.3	29.2	102.7
1967	1 131	44 001	11 308	4 739	32 693	38.9	10.0	28.9	107.7
1968	1 159	44 627	10 781	4 552	33 846	38.5	9.3	29.2	102.0
1969	1 189	46 480	10 892	4 404	35 588	39.1	9.2	29.9	94.8
1970	1 220	44 496	10 829	4 286	33 667	36.5	8.9	27.6	96.3
1971	1 254	47 060	10 312	4 215	36 748	37.5	8.2	29.3	89.6
1972	1 291	47 943	10 270	3 753	37 673	37.1	8.0	29.2	78.3
1973	1 329	47 714	10 358	4 053	37 356	35.9	7.8	28.1	84.9
1974	1 367	49 847	10 075	4 069	39 772	36.5	7.4	29.1	81.6
1975	1 406	49 310	10 018	3 961	39 292	35.1	7.1	27.9	80.3
1976	1 446	51 355	10 149	3 678	41 206	35.5	7.0	28.5	71.6
1977	1 487	49 849	9 811	3 681	40 038	33.5	6.6	26.9	73.8
1978	1 526	49 027	9 776	3 409	39 251	32.1	6.4	25.7	69.5
1979	1 566	48 125	9 575	3 424	38 550	30.7	6.1	24.6	71.1
1980	1 555	53 147	8 909	3 069	44 238	34.2	5.7	28.4	57.7
1981	1 595	48 111	9 677	3 024	38 434	30.2	6.1	24.1	62.9
1982	1 629	52 865	10 479	3 466	42 386	32.5	6.4	26.0	65.6
1983	1 664	49 645	11 040	3 437	38 605	29.8	6.6	23.2	69.2
1984	1 699	55 243	10 573	2 921	44 670	32.5	6.2	26.3	52.9
1985	1 735	53 925	11 826	3 026	42 099	31.1	6.8	24.3	56.1
1986	1 773	54 519	10 446	2 819	44 073	30.7	5.9	24.9	51.7
1987	1 811	56 221	10 307	2 848	45 914	31.0	5.7	25.4	50.7
1988	1 850	56 283	10 257	2 916	46 026	30.4	5.5	24.9	51.8
1989	1 889	53 656	10 181	2 745	43 475	28.4	5.4	23.0	51.2
1990	1 930	55 175	8 214	1 897	46 961	28.6	4.3	24.3	34.4
1991	1 967	52 263	8 526	1 761	43 737	26.6	4.3	22.2	33.7
1992	2 006	44 418	8 004	1 526	36 414	22.1	4.0	18.2	34.4
1993	2 043	44 132	7 804	1 471	36 328	21.6	3.8	17.8	33.3
1994	2 077	43 450	7 667	1 081	35 783	20.9	3.7	17.2	24.9
1995	2 113	44 776	8 671	1 058	36 105	21.2	4.1	17.1	23.6
1996	2 151	46 041	8 392	734	37 649	21.4	3.9	17.5	15.9
1997	2 186	42 920	8 624	781	34 296	19.6	3.9	15.7	18.2



## Kapitulli II.-Analizat elementare

### 2.1 Analizat

Gjatë analizimit të fenomeneve demografike për periudhën e viteve 2002 dhe 2003, duhet patur parasysh faktin se në Kosovë, ngjarjet vitale (lindjet dhe vdekjet), nuk nxirren në shkallë të mjaftueshme, ngase nuk ekziston rregullativ e mirëfilltë ligjore, që do t'i bindë qytetarët për paraqitjen e ngjarjeve në Zyrat e Ofiqarive në afat të caktuar. Andaj, nuk mund të konkludojmë bindshëm se informatat e prodhuara, prezentojnë gjendjen reale për ngjarjet demografike dhe shtimin natyror të popullsisë në Kosovë për periudhën në fjalë.

Siç kemi cek edhe më herët rritja e popullsisë në mënyrë të drejtëpërdrejt varet nga komponentet natyrore dhe mekanike të lëvizjeve të popullsisë (lindjet e gjalla, vdekjet dhe migrimet). Pra, sa më e lartë të jet shkalla e zënjes së këtyre komponenteve aq më e sakët është informata për shkallën e shtimit të popullsisë së një vendi. Megjithatë, falë angazhimit të personelit profesionist të DSP në qendren e ESK dhe në terren si dhe kontakteve me institucionet relevante, vërehet një përparim i dukshëm i paraqitjes së ngjarjeve demografike, në krahasim më periudhën fillestare të riaktivizimit të Sistemit të Statistikave Demografike më 2001.

Në bazë të dhënave të prezentuara në tabelat e këtij buletini, norma e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë, në vitin 2002 sillet rreth 13 promil, dhe më 2003 rreth 11 promil.

Në periudhat e mëhershme (1948-1988), në Kosovë, norma e shtimit natyror e popullsisë ishte më e larta në Europë pas Turqisë, mesatarisht rreth 25. promil.

Kjo normë tani, tregon një rënie për më tepër se pesëdhjet përqind (50%), që është kryesisht rezultat i mos paraqitjes së ngjarjeve. Edhe në periudhën e viteve 1990-1991, shkalla mesatare e shtimit natyror të popullsisë në Kosovë sillet rreth 23.3 promil, ndërsa, në periudhën 1992-1996, mesatarisht 16,8 promil, me tendencë të rënjes se theksuar, më 1997 në 15,7 promil. Kjo rënie e normes së shtimit natyror të popullsisë, pas vitit 1991, nuk është pasqyrë e gjendjes reale të shtimit të popullsisë në Kosovë, por është rezultat i mos bashkëpunimit (mosregjistrimit të ngjarjeve) të në pjese të popullatës shumicë me Zyrat e Gjendjes Civile.

Për shkaqe sigurie të nënës dhe fëmijës, pjesa më e madhe e lindjeve, kryheshin nëpër shtëpi, apo ordianca private, të cilat në atë kohë nuk mbanin korrenspondencë për ngjarjet vitale me sistemin e regjimit.

Kjo gjendje për një kohë shkatërroj relacionet në mes të regjistrimit të ngjarjeve vitale dhe popullsisë, dhe është e natyrshme që do të duhet kohë të rehabilitohet gjendja e krijuar. Për vitet 1998, 1999, 2000 dhe 2001, ESK nuk disponon me të dhëna për statistika demografike.


Është brengosëse, se edhe tani, ngjarjet vitale të cilat ndodhin në vendbanimet me shumicë serbe, nuk regjistrohen në Zyrat e Gjendjes Civile të Kosovës. Andaj, DSP i ESK nuk posedon informacione për atë pjesë të popullatës së Kosovës.

## **2.2.Lindjet:**

Në bazë të informatave të fituara përmes sistemit të statistikave vitale, për vitin 2002, kuptojmë se në Kosovë janë regjistruar 36347 lindje, prej tyre 36136 të lindur të gjallë, ndërsa 211 të lindur të vdekur.


Koeficienti i lindjeve të përgjithshme ishte 15.2 promil (numri i lindjeve bruto në 1000 banorë), koeficienti i lindjeve të gjalla 15.1 promil (numri i lindjeve të gjalla në 1000 banorë), koeficienti i vitalitetit 6.4 (numri i të lindurëve gjallë në 100 persona të vdekur) dhe norma e shtimit natyror 12.8 promil. Raporti i gjinisë të lindjet ishte 1.08, që nënkupton se në 100 femra të lindura gjallë vinin 108 mashkuj. Koeficienti i lindjeve të vdekura - vdekjeve fetale në 1000 lindje ishte 5.8 promil.

Në vitin 2003, në Kosovë janë regjistruar gjithsej 32186 lindje, prej tyre 31994 të lindur të gjallë, ndërsa 192 të lindur të vdekur. Koeficienti i lindjeve të përgjithshme ishte 13.3 promil, koeficienti i lindjeve të gjalla 13.2 promil, koeficienti i vitalitetit 5.0, norma e shtimit natyror 10.5 promil, ndërsa, raporti i gjinisë të lindjet ishte 1.10 (shih graf.1).




Koeficienti i lindjeve të vdekura- vdekjeve fetale në 1000 lindje ishte 6.0 promil.

Në vitin 2002 dhe 2003, mesatarisht rreth 85.6% e lindjeve kanë ndodhur në institucionet mjekesore (med), 1.1% në vend tjetër, dhe rreth 13.3% në shtëpi. (shih graf.2).




Sipas grup-moshave, numri më i madh i nënave që kanë lindur fëmijë, është i grup-moshave 25-29 vjeç 36,8% (prej lindjeve të përgjithshme), pastaj i grup-moshave 20-24 vjeç 25%, grup-moshat 30-34 vjeç 23,4%, dhe grup-moshat tjera përbëjnë 14.8% të numrit të përgjithshëm të lindjeve të gjalla. (shih graf.3).

Mosha mesatare e femrave që kanë lindur fëmijë në vitin 2003, ishte rreth 28 vite, dhe nuk ka dallime krahasuar me vitin 2002.




Sipas radhës së lindjes së fëmijut, 37.8%, e nënave janë që kanë lindur fëmijun e parë 27.3% përbëjnë nënat që kanë lindur fëmijën e dytë, 18% fëmijën e tretë dhe 17% të numrit të përgjithshëm përbëjnë nënat që kanë lindur 4 e më tepër fëmijë. (shih graf.4)




Sipas peshës së fëmiut të lindur, numri më i madh i foshnjeve është me peshë 3000-3499gr. apo 34.1% , pastaj 24.9% foshnjët me peshë 3500-3999gr.

Foshnjët e lindura me më pak se 3000gr. peshë përbëjnë 19.2% të numrit të përgjithshëm të të lindurve të gjallë, ndërsa 7.5% janë lindjet me peshe mbi 4000gr.

Për fëmijët e lindur jashtë institucionit mjekësor, sipas metodologjisë së hulumtimit nuk kerkohën të dhënat për peshën e tyre. ( shih graf.5).




Grafikoni 6 dhe 7, tregon se niveli i arsimimit të nënës ka ndikuar në zvogëlimin e lindjeve në krahasim me nënat me nivel më të ulët të arsimimit.




### 2.3. Vdekjet:

Në vitin 2002, janë regjistruar 5654 raste të vdekjeve, prej të cilave 3348 apo 59.2% meshkuj dhe 2306 apo 40.8 femra. Raporti i gjinisë të vdekjet (numri i meshkujve të vdekur në 100 femra të vdekura), është pa oscilime të ndieshme për të dy vitet rreth 1.4. Prej të gjitha vdekjeve të regjistruara 403 janë foshnje.

Në vitin 2003, janë regjistruar 6417, raste të vdekjeve, prej të cilave 3741 apo 58.3% meshkuj dhe 2676 apo 41.7% femra.(shih graf.8)



Është brengosëse, se në Kosovë më 2002 dhe 2003, mbi 60% të rasteve të vdekjeve kanë ndodhur në shtëpi, dhe vetëm 40% në spital. Për rastet që ndodhin në shtëpi me vështirësi apo edhe nuk sigurohen fare të dhënat për shkakun e vdekjes dhe veçorit tjera të domosdoshme që kërkohen me skedën staistikore (DEM-2).(Shih graf 9).



*-Në bazë të lëvizjeve të popullsisë në periudhën 1948-1997, vlerësimeve për periudhën 1998-2004, sidhe supozimit se zënia e ngjarjeve demografike (lindjeve dhe vdekjeve), do të ishte mbi 95% në vitin 2002 dhe 2003, koeficienti i lindjeve (natalitet) do të ishte rreth 22 promil, koeficienti i vitalitetit 5.5%, norma e shtimit natyror 18.0 promil, koeficienti i vdekshmërisë(mortaliteti) 5.0 promil dhe koeficienti i vdekshmërisë infantile (mortaliteti i foshnjeve) rreth 30 promil.*


## 2.4. Kurorëzimet:

Në vitin 2002, në Kosovë janë regjistruar 18280 kurorëzime.

Shiqar sipas grupmoshave, numri më i madh i kurorëzimeve është: të femrat ndërmjet moshës 20-24 vjeç që përbënin 37.6% të numrit të përgjithshëm të femrave të kurorëzuara, ndersa të meshkujt i moshave 25-29 vjeç, që përbënin 33.6% të numrit të përgjithshëm të meshkujve të kurorëzuar.

Mosha mesatare e kurorëzimeve, në shkallë vendi, në vitin 2002 ishte 27 vjeç (e burrit 29 ndërsa e gruas 25.8 vjeç).

Në vitin 2003, janë regjistruar 17034 kurorëzime. Numri më i madh i kurorëzimeve është: të femrat ndërmjet moshës 20-24 vjeçare që përbëjnë 36.7% të numrit të përgjithshëm të femrave të kurorëzuara, ndersa të meshkujt i moshave 25-29 vjeç, që përbëjnë 33.0% të numrit të përgjithshëm të meshkujve të kurorëzuar. Në shkallë vendi, mosha mesatare e kurorëzimeve ishte 28 vjeçare, (burrit 30 vite ndërsa, gruas-26).



## 2.5 Lindjet, vdekjet dhe kurorëzimet sipas muajve 2002-2003

